



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 192/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Pura-Medical” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-55441-04-02-2020, me objekt: *“Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve infekte spitalore”*, me fond limit 5,530,000 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 14.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut.

Ankimues: “Eco Riciklim” sh.p.k
L.Mëzez, Rruga dytësore Kashar, ZK2679, Pasuria 12/22, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Pura - Medical” sh.p.k
Ish Reparti i Kipit të Furrnaltes, Kombinati Metalurgjik, Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut
Rruga Lord Bajron, Laprakë, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.04.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-55441-04-02-2020, me objekt: “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve infekte spitalore”, me fond limit 5,530,000 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 14.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut.

II.2. Në datën 24.04.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|-----------------------------|
| • “Pura - Medical” sh.p.k | 2.786.000 lekë, kualifikuar |
| • “Eco Riciklim” sh.p.k | 3.472.000 lekë, kualifikuar |
| • “Medi-Tel” sh.p.k | 4.116.000 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 30.04.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik "Pura-Medical" sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

" [...]

Ne nuk jemi dakord me rezultatet e vleresimit ne lidhje me kualifikimin e shoqerise Pura-Medical, pasi, duke qene se jemi nje operator serioz dhe me lidhje dhe njohuri shume te mira ne treg, kemi pasur mundesine te kemi informacion te sakte per mangesite e ketij OE, dhe paraqesim kundërshtimet tona ne vijim:

1. OE Pura-Medical nuk ploteson kriterin e vendosur ne piken 2.3.3 te Shtojces 7. Ne Dokumentat e Tenderit, Shtojca 7, pika 2.3.3 kerkohet si vijon:

Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme sipas objektit qe prokurohet, si me poshte:

- ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit cilesise".

Ne zbatim te rekomandimit te APP dhe DPA date 20.03.2018, te gjitha certifikatat e cilesise duhet te jene te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilet jane te akredituar nga DPA, ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise." Ne kemi dijeni se shoqeria Pura-Medical pretendon se e permbush kete kriteri, me nje Certificate ISO 9001:2015 me nr.568 Q, te leshuar nga organizmi certifikues i sistemeve te menaxhimit TOTAL Q ARM. Ky organizem certifikimi eshte i akredituar per certifikime ISO 9001:2015 nga ESYP (organi akreditues grek) me Certifikaten akredituese nr.945-3 qe gjendet ne faqen zyrtare te ESYP ne linkun <http://ëë.esyd.gr/portal/p/esyd/en/shoëOrgInfo.jsp?id=18184> (bashkelidhur edhe certifikata e shkarkuar nga ky link).

Se pari, ne konstatojme se kur kerkojme ne faqen zyrtare te TOTAL Q ARM per Certifikaten ISO 9001:2015 te disponuar dhe perdorur nga Pura-Medical, ne linkun <https://totalqarm.com/en/check-certifications-iso/?company=PURA+MEDICAL> rezulton se kerkimi del 0, pra kjo shoqeri nuk e njeh asnje certificate ISO te leshuar per shoqerine Pura-Medical (bashkelidhur edhe printscreen i kerkimit).

Se dyti, sipas Certifikates akredituese nr.945-3 te organizmit certifikues TOTAL Q ARM qe gjendet ne faqen zyrtare te ESYP, fusha e mbulimit te certifikimit per ISO 9001:2015 nuk e perfshin menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore. Kjo mund te verifikohet nga lista e aktiviteteve qe mund te mbulohen me certifikim nga TOTAL Q ARM, kodet e te cilave tregohen ne kollonen e pare te tabelës. Ne fund te tabelës eshte shenimi sqarues per kodet qe lexon: "EA/IAF Code according to IAF ID 1:2014".

Kur i referohemi dokumentit IAF ID 1 :2014, te cilin po e bashkelidhim ne kete ankese, ne faqen 4 te tij eshte percaktuar se: "The lists of scopes of accreditation are based on the statistical Nomenclature for economic activities NACE rev. 2 published by the Commission of European Communities (official Journal L 393/1, 30.12.2006)" perkthimi ne shqip i te ciles eshte "Lista e fushave te akreditimit mbeshetet ne nomenklaturen statistikore per aktivitetet ekonomike NACE vers. 2 publikuar nga Komisioni European (Gazeta zyrtare L 393/ 1, 30.12.2006)"

Me tej ne faqen 5 te ketij dokumenti eshte Aneksi me fushat e akreditimit, ku ne Tabelen e pare jane kodet per QMS (Quality Management System) sipas kodeve IAF te shtjelluara seicili perbri me kodet NACE te detajuara. nese i referohemi kodeve te detajuara NACE (bashkelidhur lista kodeve nga fq. 59 - 90 te dokumentit zyrtar i shkarkuar nga <https://ec.europa.eu/eurostat/en/ëeb/products-manuals-and-guidelines/-/KS-RA-07-015>), duket

qarte ne fq.71 se aktivitetet e menaxhimit te mbetjeve jane klasifikuar ne NACE me kodin 38.1 dhe 38.2.

Duke iu rikthyer tabelës së kodeve IAF, rezulton se kodet NACE 38.1 dhe 38.2 i korrespondojnë kodit IAF me nr.39. Kodi IAF me nr.39, nuk është i përfshirë në fushën e akreditimit të organizmit TOTAL Q ARM, pra ky organizëm nuk mund të leshojë Certifikata 9001:2015 për aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve spitalore.

Pra si konkluzion Certifikata e perdorur nga Pura-Medical ISO 9001:2015 me nr.568 Q, e leshuar nga organizmi certifikues i sistemeve të menaxhimit TOTAL Q ARM në rastin me të keq është fiktive dhe nuk ekziston fare, dhe sidomos në rastin me të mirë, nuk është një certifikatë e vlefshme e leshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilët janë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, sic kërkon kriteri.

Mungesa e mesiperme, përben shkak për skualifikim.

2. OE Pura-Medical nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3.4 të Shtojcës 7

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 7, pika 2.3.4 kërkohet si vijon:

Për transportin e mbetjeve, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht 1 (një) automjet të izoluar hermetikisht me kapacitet transportues jo më pak se 200 Kg, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjen dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore (në përputhje me pikën 8.8/c dhe Shtojcën nr.4 të VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhezuesin Kombëtar "Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore", Seksioni: 9:33-"Automjetet/anijet e grumbullimit"). Operatori duhet të paraqesë dokumentacionin për vertetimin e pronësive ose të marrjes me qera të mjetit.

Për të vertetuar këto kriter operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Për automjetin në pronësi: Aktin e pronësive së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe policia e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjienosanitare, si dhe foto të mjetit ku të duket qarta targa dhe sinjalistika përkatëse sipas udhëzuesit kombëtar "Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore".

Për automjetet që nuk janë në pronësi: Kontrata qiraje të shoqëruar me aktin e pronësive së qiradhenesit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe policia e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjienosanitare, si dhe foto të mjeteve ku të duket qarta targa dhe sinjalistika përkatëse.

Nga vezhimi në qarkullim i automjeteve të shoqëruar nga Pura-Medical jemi të sigurt se automjetet e kësaj shoqërie nuk janë të pajisura me sinjalistikën e detyrueshme të automjeteve të grumbullimit të mbetjeve spitalore.

Sinjalistika në fjalë, formati i saj, ngjyrat, fjalet, permasat dhe pozicionimi në automjete janë të përcaktuara qarta në Shtojcat nr.2 dhe nr.4 të VKM Nr.798 datë 29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhezuesin Kombëtar "Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore", Seksioni: 9.3.3 "Automjetet/anijet e grumbullimit". Nëse KVO do të kishte verifikuar me kujdes fotot e mjeteve të paraqitura nga Pura-Medical, do ta kishte konstatuar se ky kriter nuk përmbushet.

Mungesa e mesiperme, përben shkak për skualifikim.

3. OE Pura-Medical nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3.5 të Shtojcës 7

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 7, pika 2.3.5 kërkohet si vijon:

Operatori ekonomik duhet te paraqese nje kontrate aktive me nje Landfill te licensuar, per depozitim te produktit final qe del nga asgjeksi, e cila duhet te jete e vlefshme.

Ne kemi dijeni se shoqeria Pura-Medical ka pasur kontrate per kete qellim te lidhur ne Janar 2020 me shoqerine Albtek Energy e cila operon venddepozitim dhe impiantin e mbetjeve te Elbasanit.

Nga eksperiencia jone e meparshme ne kontraktimin me kete shoqeri (Albtek Energy), na rezulton se kjo shoqeri i nderton kontratat e veta me afat 1 mujor dhe ne dijenine tone shoqeria Pura-Medical nuk ka rinovuar kete kontrate pas afatit 1 mujor, pra ne daten e paraqitjes se ofertave nuk ka pasur nje kontrate me landfill te licensuar, sic kerkohet ne kete kriter.

Mungesa e mesiperme, perben shkak per skualifikim.

4. OE Pura-Medical nuk ploteson kriterin e vendosur ne piken 2.3.5 te Shtojces 7

Ne Dokumentat e Tenderit, Shtojca 7, pika 2.3.5 kerkohet si vijon:

Dokument qe verteton se ka ne pronesi ose me qera impjant incenerimi dhe/ose autoklavimi te evidentuar ne Leje Mjedisore, me kapacitet te mjaftueshem (te trajtoje minimumi 40 kg/dite) per te perballuar sasine e mbetjeve spitalore objekt i ketij prokurimi. Per te provuar permbushjen e ketij kriteri, operatorete duhet te paraqesin:

a. Dokument qe provon pronesine apo disponimin me qera ne nje nga menytrat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kontrate blerje ose qeraje, fature blerje ose zhdoganimi).

b. Karten teknologjike te impiantit/impianteve.

c. Deklaraten e Konformitetit CE te impiantit/impianteve te leshuar nga kompania prodhuese

a. Ne lidhje me dokumentacionin e inceneratorit

***Se pari**, ne dijenine tone, nga eksperiencia ne tendera te tjere te zhvilluar, ku kemi marre pjese e garuar bashke me kete shoqeri, na rezulton se shoqeria Pura-Medical, paraqet ne tendera nje lloj dokumentacioni qe ajo e konsideron si karte teknologjike te impiantit incenerator, prodhim kinez, qe ne fakt nuk eshte e tille. Nje dokumentacion i tille, nuk mund te konsiderohet i vlefshem dhe nuk e permbush kriterin e vendosur nga AK, pasi karta teknologjike, eshte dokumentacioni teknik i hartuar dhe i leshuar nga prodhuesi qe si rregull shoqeron gjithmone nje impiant per te dhene siguri per kedo ne lidhje me karakteristikat teknike, te dizajnit dhe ato funksionale te pajisjes se prodhuar prej tij.*

***Se dyti**, nga AK eshte kerkuar per kete kriter qe te paraqitet edhe Deklarata e Konformitetit CE per impiantet. Sqarojme ne kete rast se Deklarata e Konformitetit CE per impiante te kesaj natyre eshte e natyres Deklarate qe plotesohet dhe leshohet nga prodhuesi i impiantit, dhe qe konfirmon perputhshmerine me Direktivat 2006/42/EC (MD - Machinery Directive) dhe 2006/95/EC (LVD*

- Loë Voltage Directive).

Deklarata e Konformitetit CE per keto lloj impiantesh duhet te plotesoje te gjitha kerkesat e pikes I.A te Aneksit II te Direktives 2006/42/EC (MD - Machinery Directive), sic eshte Deklarata e Konformitetit e paraqitur prej nesh. Ne dijenine tone, impianti qe perdor shoqeria Pura-Medical nuk e ka nje te tille. Kjo gjithashtu perben mosplotesim te kriterit.

b. Ne lidhje me dokumentacionin e autoklaves

Ne dijenine tone, dokumentacioni shoqerues i Lejes Mjedisore se shoqerise Pura-Medical te leshuar ne daten 21.12.2018 me Akt Miratimi te dates 20.12.2018, ne lidhje me autoklaven nuk ka

as karte teknologjike dhe as Deklarate Konformiteti CE, madje as nuk e ka te identifikuar ne Lejen Mjedisore modelin dhe llojin e autoklaves se licencuar. Pra ky OE nuke permbush kriterin e paraqitjes se kartes teknologjike dhe Deklarates e Konformitetit CE per autoklaven.

Edhe nese eshte paraqitur ndonje dokumentacion per ndonje impiant autoklave, ai nuk mund te konsiderohet i sakte dhe i mjaftueshem per permbushjen e kriterit, qe percakton shprehimisht se impianti duhet te jete i " ... evidentuar ne Leje Mjedisore ... ", pasi cdo dokumentacion i paraqitur duhet te korrespondoje me autoklaven e percaktuar ne Lejen Mjedisore perkatese, dhe sic theksuam, nese ky OE do te kishte te tilla dokumenta, ato duhet te perputhen me teknologjine e percaktuar dhe te lejuar ne lejen mjedisore, perndryshe nuk kane asnje vlere.

Mangesite e mesiperme, perbejne gjithashtu shkak per skualifikim.

Ne perfundim, pasi parashtruam sa me siper, kerkojme te rishikohet vleresimi i ofertes se OE Pura - Medical dhe oferta e tij te skualifikohet dhe te refuzohet."

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 109/1 prot., datë 04.05.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

"Bazuar ne ankesen tuaj me Nr.109 Prot, date 30.04.2020, per proceduren "Kerkese per propozim" me objekt: "Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve infekte spitalore", - Marrveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara per nje periudhe 12 mujore. Fondi Limit i Mareveshjes Kuader: 5,530,000 (Pese milione e peseqind e tridhjetete mije) Leke pa TVSH, financuar nga buxheti i Shtetit. Numri i references se procedures: REF-55441-04-02-2020, ju sqarojme si me poshte:

Grupi i shqyrtimit te ankeses pasi shqyrtoi kerkesen tuaj, nga permbajtja e saj del se ankoheni:

- Per vleresimin e bere nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave (KVO) te QTKGJ ngritur per kete procedure prokurimi, me pretendimin qe vetem OE i renditur ne vendin e pare sipas ofertes me te ulet nuk ka dokumentat e kualifikimit.*
- Nuk ankoheni per OE tjeter pjesmarres.*
- Kerkon ndryshimin e vleresimit te bere nga KVO, duke skualifikuar OE e renditur ne vendin e pare sipas parimit te "cmimit me te ulet",*

KSHA pasi shqyrtoi pretendimet tuaja, beri verifikimet ne dokumentacionin e paraqitur nga OE renditur ne vendin e pare, per te cilin kerkoni te skualifikohet, dhe vendosi te mos mare ne konsiderate kerkesen tuaj, duke mos ndryshuar vleresimin e KVO te QTKGJ per keto arsye:

OE ankohet per vleresim te padrejte bere nga KVO, ku kerkon vetem skualifikimin e OE renditur ne vendin e pare sipas parimit te cmimit me te ulet,

Rikujtojme OE se nuk mund te ankohet per operatore te tjere ekonomike kur vete ata jane te kualifikuar. Ne kete procedure KVO nuk ka skualifikuar asnje OE pjesmarres.

Pretendimet tuaja nuk qendrojne pasi nuk jane te bazuara ne LPP, por jane aludime.

KVO ka bere vleresim te drejte dhe nuk ka gabuar, kjo bazuar ne verifikimet perkatese, dokumentacioni i pretenduar se mungon gjendet ne Sistemin Elektronik te APP-se.

KSHA ka konstatuar se dokumentacioni i dorezuar nga OE renditur ne vendin e pare (sipas parimit te cmimit me te ulet) jane sipas kerkesave per kualifikim ne DT te kerkuara nga AK te publikuara ne SPE.

Pasi ankesa juaj u shqyrtua me kujdes, KSHA vendosi: - te mos e mar parasysht Ankesen. Per sa me siper, grupi qe ka per detyre te shqyrtoje ankesen i verifikoi pretendimet e OE dhe vendosi ne baze te LPP dhe VKM nr.914 date 29.12.2014 i ndryshuar. Si perfundim, vleresojme se ankesa e juaj te mos merret parasysht.”

II.6. Në datën 11.05.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 15.05.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 392/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 127/1 prot., datë 15.05.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k se: “[...] *ne dijenine tone, nga eksperiencia ne tendera te tjere te zhvilluar, ku kemi marre pjese e garuar bashke me kete shoqeri, na rezulton se shoqeria Pura-Medical, paraqet ne tendera nje lloj dokumentacioni qe ajo e konsideron si karte teknologjike te impiantit incenerator, prodhim kinez, qe ne fakt nuk eshte e tille. Nje dokumentacion i tille, nuk mund te konsiderohet i vlefshem dhe nuk e permbush kriterin e vendosur nga AK, pasi karta teknologjike, eshte dokumentacioni teknik i hartuar dhe i leshuar nga prodhuesi qe si rregull shoqeron gjithmone nje impiant per te dhene siguri per kedo ne lidhje me karakteristikat teknike, te dizajnit dhe ato funksionale te pajisjes se prodhuar prej tij*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 9 e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshte vijon:

“Dokument qe verteton se ka ne pronesi ose me qera impjant incenerimi dhe/ose autoklavimi te evidentuar ne Leje Mjedisore, me kapacitet te mjaftueshem (të trajtojë minimumi 40 kg/ditë) per te perballuar sasine e mbetjeve spitalore objekt i ketij prokurimi. Per te provuar permbushjen e ketij kriteri, operoret duhet te paraqesin:

a. Dokument qe provon pronesine apo disponimin me qera ne nje nga menytrat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kontrate blerje ose qeraje, fature blerje ose zhdoganimi).

b. Karten teknologjike te impiantit/impienteve.

c. Deklaraten e Konformitetit CE te impiantit/impienteve te leshuar nga kompania prodhuese”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Pura-Medical” sh.p.k për përmbushjen e kërkesës për kartën teknologjike, rezulton se është dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë blerjeje e inceleratorit (Model WFS-30) nga kompania Shandong Better Environmental Protection Technology Co, Ltd, datë 17.08.2017, shoqëruar me mandat pagesat bankare.
- Kartën teknologjike të Incelerator WFS-30, i cili rezulton “screenshot” i realizuar nëpërmjet aparatit celular.
- Deklaratën Konformiteti CE.

III.1.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.4. Në nenin 28 pika 5, gërma “ç” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. Në Dokumentat Standarte të Tenderit, në Shtojcën “Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes”, lidhur me kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe kriteret e vecanta të kualifikimit, është përcaktuar shprehimisht:

“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”

III.1.6. Në Manualin e përdorimit të sistemit elektronik për operatorët ekonomik, hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, përcaktohet:

“Dokumentat e skanuar duhet të jenë origjinal ose kopje e noterizuar, versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet në sistemin elektronik të prokurimit për një procedurë konkrete është i barasvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar”.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit

Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se operatori ekonomik “Pura-Medical” shpk, ndër të tjera, në drejtim të provueshmërisë së kapacitetit teknik për Incelatorin, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për kartën teknologjike të impiantit në fjalë, rezulton se ky subjekt ka dorëzuar dokument “screenshot” të realizuar nëpërmjet aparatit celular për objektin “WFS-30 Incinerator From Chris...”.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për kartën teknologjike është e një rëndësie të vecantë për procedurën e prokurimit për faktin se jep garanci për autoritetin kontraktor për përmbushjen dhe realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Në analizë të kartës teknologjike, të paraqitur nga operatori ekonomik “Pura-Medical” shpk në sistemin e prokurimeve elektronike, nuk rezulton që ky dokument të jetë origjinal ose kopje e noterizuar e tij, pasi është realizuar me “screenshot” nga një aparat i telefonisë së levizshme dhe vjen në kundërshtim me kërkesat e dokumentave standarte të tenderit sipas të cilit *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”* dhe manualin e përdorimit të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që, nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik, të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet për realizimin me sukses të kontratës, fakt ky që duhet vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në kriteret kualifikuese.

Sa më sipër analizuar, konstatojmë se, jemi në kushtet kur nga ana e operatorit ekonomik “Pura-Medical” shpk nuk është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me dokumentacionin për kartën teknologjike të Incelatorit pasi, në rastin konkret operatori ekonomik ankimes nuk e disponon atë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Eco Riciklim” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Pura-Medical” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-55441-04-02-2020, me objekt: “Evadimi dhe trajtimi i mbetjeve infekte spitalore”, me fond limit 5,530,000 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 14.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Pura-Medical” sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 392 Protokolli

Datë 11.05.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha